



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.86/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- me seli në Prizren, parashtruar kundër kandidatit Nedžmidin Sejdilar - kandidat i pavarur për Kryetar Komune në Komunën e Dragashit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- me seli në Prizren, ZL.Anr.86/2025 datë 29.09.2025.

II. Kandidati i pavarur për Kryetar Komune - Nedžmidin Sejdilar, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1,000.00 Euro (njëmijë Euro).

III. Detyrohet kandidati i pavarur - Nedžmidin Sejdilar që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet kandidati i pavarur (Nedžmidin Sejdilar), që nga momenti i marrjes së këtij vendimi t’i largoj nga rrjeti social Facebook postimet e datës 29.09.2025.

A r s y e t i m

Me datë 30.09.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- me seli në Prizren, në të cilën pretendohet se kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, z. Nedžmidin Sejdilar, gjatë fushatës zgjedhore të dt. 29.09.2025, rreth orës 12:30, në profilin e

tij në Facebook, ka bërë një publikim, si dhe një trasmetim të drejtpërdrejtë në tri media: Radio Bambus, Radio Sharri dhe TV Opoja. Me tutje thekson se në foltorën e kuvendit dhe në jakën e setrës së tij ka vendosur emblemen “Populli ka fuqinë 102”, të cilën e ka shfrytëzuar si arritje të tij personale politike. Në publikime janë përdorur video dhe fotografi në të cilat gjendet kandidati, duke krijuar kështu përshtypjen e identifikimit politik me burimet publike dhe aktivitetet e organeve shtetërore, duke keqpërdorur burimet publike dhe detyrën e tij zyrtare për qëllime të promovimit zgjedhor dhe ndikimit tek elektorati. Publikimet e lartcekura janë publikuar në rrjetin social Facebook si dhe në radiot Radio Bambus, Radio Sharri dhe TV Opoja. Me veprimet e sipërpërmendura, kandidati i lartëcekur ka shkelur dispozitat e nenit 36 paragrafi 1, i LZP-së duke përdorur resurset shtetërore të nivelit lokal për qëllim të fitimit të votave. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartëcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë të kandidatit të pavarur theksohet se duke i'u referuar ankesës së paraqitur nga subjekti politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- Duda Balje me seli në Prizren, lidhur me pretendimin se kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullorës Zgjedhore Nr.11/2013 – Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Në ankesën e parashtruar në pikën D, - Arsyeja për paraqitjen e ankesës, ankuesja ketë fushë e ka lënë të zbrazur, ndërsa në vendin dhe kohën dhe datën, ka shënuar : seancën e asamblesë komunale të dt. 29.09.2025, Komuna e Dragashit, salla e kuvendit komunal, si dhe profili im personal në Facebook, dhe trasmetimi live në tri shtëpi mediale 1. Radio Bambus, 2.Radio Sharri, dhe 3. TV Opoja. Me tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se tek përshkrimi i shkeljes ka shënuar se: Gjatë fushatës zgjedhore kandidati i pavarur për kryetar komune Nedžmidin Sejdilar postoi “NAROD JE SNAGA 102” në profilin e tij në Facebook, pas kryesuesit të asamblesë dhe në jakën e xhaketës së tij, si sipërmarrje e tij politike. Po ashtu sa i përket ankesës, deklarohet se nuk është e vërtetë që jam kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit, dhe njëherësh kandidat i pavarur për asamble komunale të Dragashit, pasi që aktualisht Asamblist, dhe në ketë mbledhje kemi diskutuar lidhur me buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2026 dhe për tema të ndryshme që i preokupojnë banorët e Komunës së Dragashit. Konsideron se nuk kishte vepruar kundërligjshëm dhe se veprimet e tij në seancën e rregullt të Asamblesë Komunale të Dragashit, shpërndarja e videove ku paraqet punën si asambleist, është e garantuar me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si e drejtë e fjalës së lirë, gjithmonë me gjuhë korrekte ndaj subjekteve tjera politike. Andaj, bazuar në argumentet e sipërshënuara te përgjigjes në Ankesë nr. 86/3-2025, parashtruar nga kandidati i pavarur për Komunë të Dragashit z. Nedžmidin Sejdilar, shqyrtimit të provave të parashtruara nga palët i propozojmë PZAP-së, që ta nxjerr këtë vendim të refuzuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- **Ankesa është e bazuar.**

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- Duda Balje me seli në Prizren, dhe shkresave tjera të lëndës, është vërtetuar se kandidati i pavarur për Komunë të Dragashit z. Nedžmidin Sejdilar, duke shfrytëzuar pozitën publike e me qëllim të përfitimit të votave ashtu që në fjalën e mbajtur para anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se kandidati i pavarur për Komunë të Dragashit z. Nedžmidin Sejdilar ka shfrytëzuar hapësirat e brendshme të komunës së Dragashit respektivisht ka shfrytëzuar foltorën e kuvendit dhe në rrobat e tij ka vendosur emblemen *“Populli ka fuqinë 102”*, i cili edhe është slogani e tij në këto zgjedhje të cilën e ka shfrytëzuar si arritje të tij personale politike, e të cilin fakt nuk e ka mohuar me rastin e parashtrimit të përgjigjes në ankesë.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatit të pavarur për Komunë të Dragashit z. Nedžmidin Sejdilar, bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që i njëjti me këto veprime-kërkesa ndaj qytetarëve të Dragashit ka pasur qëllim të vetëm përfitimin e votave në zgjedhjet lokale që do të mbahen me 12 tetor 2025.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, faktin se i njëjti është kandidat i pavarur, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, ku i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 1,000.00 euro.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.86/2025 më datën 03.10.2025

Kryesues i Panelit,

Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.